



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 142, Datë 06.09.2017

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË
LLOGARITJES SË TARIFËS SË PËRDORIMIT TË RRJETIT TË TRANSMETIMIT
DHE SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR.**

Në mbështetje të neneve 16; 32 dhe 33 të Ligjit nr. 102/2015, “Për Gazin Natyror”, si dhe nenit 26 të “*Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s*”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.09.2017, mbasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve mbi miratimin e “*Metodologjisë së llogaritjes së tarifave për përdorimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror*”,

Konstatoi:

- ERE është organi kompetent që miraton metodologjinë dhe përcakton tarifat për përdorimin e rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes, tarifat e lidhjes me rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes, tarifat për aksesin në hapësirat e depozitimit dhe impiantet e GNL-së dhe tarifat e furnizimit për klientët fundorë që furnizohen në bazë të detyrimit të shërbimit publik.
- Kjo metodologji mbështetet në parashikimet e neneve 16, 32 dhe 33 të ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “*Metodologjisë së llogaritjes së tarifave për përdorimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror*”.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE
Petrit AHMETI**